

Speciale

Minority NEWS

buletin mujor mbi jetën e komuniteteve pakicë
në Serbi

tetor
2014

botim special me rastin e zgjedhjeve të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare

Zgjedhjet për Këshill Kombëtar të Pakicës Kombëtare Shqiptare



Një e pesta e qytetarëve të
Serbisë zgjedhin përfaqësuesit
e tyre

26 tetor 2014.

www.izbori.minoritynews.rs



ИЗАЋИ И ГЛАСАЈ!
DIL DHE VOTO!

26.10.2014.

Избори за Национални савет
албанске националне мањине

Zgjedhjet për Këshill Kombëtar të
Pakicës Kombëtare Shqiptare



Centar za istraživanja migracija
Center for Migration Studies



USAID | **SERBIA**
FROM THE AMERICAN PEOPLE



ORARIN

Nr. rendor	Aktiviteti	Afati
1. Formularët dhe rregullat		
1.1	Përcaktimi dhe publikimi i formularëve dhe rregullave për realizimin e aktiviteteve zgjedhore	më së voni der më 30 gusht në orën 24:00 më së voni der më 30 gusht në orën 24:00
2. Organet dhe trupat për realizimin e zgjedhjeve		
2.1	Miratimi i vendimit për përcaktimin e numrit, përbërjes dhe sferës së punës së trupave punuese	më së voni më 25 shtator, në orën 24:00
2.2	Paraqitja e propozimeve për anëtarë të trupave punuese	në afat prej pesë ditësh nga miratimi i vendimit nga pika 2.1.
2.3	Formimi i trupave punuese	më së voni deri më 5 tetor në orën 24:00
2.4	Paraqitja e propozimeve për anëtarët e komisioneve zgjedhore në Komisionin Zgjedhor Republikan	më së voni deri më 10 tetor në orën 24:00
2.5	Formimi i komisioneve zgjedhore	më së voni deri më 15 tetor në orën 24:00
2.6	Zëvendësimi i anëtarit të komisionit zgjedhor	më së voni deri më 20 tetor, në orën 24:00
3. Lista zgjedhore		
3.1	Paraqitja e listës zgjedhore	deri më 10 tetor, në orën 24:00
3.2	Shpallja e listës zgjedhore	menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i marrjes së listës zgjedhore, nëse i plotëson kushtet
3.3	Tërheqja e listës zgjedhore	deri në ditën e përcaktimit të listës përmbledhëse zgjedhore, respektivisht më së voni 14 tetor, në orën 24:00
3.4	Përcaktimi dhe publikimi i listës përmbledhëse zgjedhore në „Gazetën zyrtare të Republikës së Serbisë”	15 tetor
3.5	E drejta e shikimit në dokumentacionin, i cili është paraqitur me listën zgjedhore	në afat prej 48 orësh, nga dita e publikimit të listës përmbledhëse zgjedhore
4. Qendrat e votimit		
4.1	Paraqitja e të dhënave në Mjestrinë e Drejtësisë për numrin e votuesve, që në ditën e zgjedhjeve do të gjenden në paraburgim ose në vuajtje të dënimit me burg	më së voni deri më 30 shtator, në orën 24:00
4.2	Caktimi dhe publikimi i vendotimeve në „Gazetën zyrtare të Republikës së Serbisë”	më së voni deri më 5 tetor në orën 24:00
5. Listat e veçanta zgjedhore		
5.1	Regjistrimi dhe ndryshimet në listën e veçantë të votuesve nga ana e administratës komunale/apo të qytetit	deri në përmbylljen e listës së veçantë zgjedhore, respektivisht më së voni 10 tetor
5.2	Miratimin e Vendimit për përmbylljen e listave të posaçme zgjedhore të pakicave kombëtare	10 tetor
5.3	Dorëzimin e Vendimit për përmbylljen e listave të veçanta zgjedhore në Komisionin Republikan Zgjedhor	11 tetor
5.4	Publikimin e Vendimit mbi përmbylljen e listave të posaçme zgjedhore në „Gazetën zyrtare të Republikës së Serbisë”	11 tetor
5.5	Dorëzimi në Komisionin Zgjedhor Republikan i deklaratave të vërtetuara nga listat e veçanta zgjedhore	brenda 48 orëve, nga përmbyllja e listës së veçantë të votuesve, ose më së voni 12 tetor, në orën 24:00
5.6	Regjistrimi dhe ndryshimet në listën e veçantë të votuesve nga ana e Ministrisë së Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale pas përmbylljes së listës së posaçme zgjedhore	nga përmbyllja e listës së posaçme zgjedhore deri më 22 tetor, në orën 24:00
5.7	Pranimi në Komisionin Zgjedhor Republikan të vendimeve të Ministrisë së Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale mbi të cilat mbështeten ndryshimet në listën e veçantë të votuesve, pas përmbylljes së listës së veçantë zgjedhore	deri më 23 tetor, në orën 24:00
5.8	Përcaktimi dhe publikimi në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë” të numrit përfundimtar të zgjedhësve për çdo pakicë kombëtare	menjëherë pas skadimit të afatit për pranimin e vendimeve mbi të cilat mbështeten ndryshimet në listën e veçantë zgjedhore
6. Përfaqësuesit e propozuesve dhe vëzhguesit		
6.1	Informimi i propozuesve të listës së shpallur zgjedhore mbi përfaqësuesit për monitorimin e punës së Komisionit Republikan Zgjedhor	deri më 20 tetor
6.2	Informimi i propozuesve të listës së shpallur zgjedhore mbi përfaqësuesit për monitorimin e punës së komisioneve zgjedhore	deri më 15 tetor
6.3	Paraqitja e kërkesës për monitorimin e punës për zhvillimin e zgjedhjeve – vëzhguesve vendore	deri më 20 tetor
6.4	Paraqitja e kërkesës për monitorimin e punës së organeve	deri më 15 tetor
7. Zhvillimi i zgjedhjeve		
7.1	Dorëzimi i njoftimeve votuesve në lidhje me datën dhe kohën e zgjedhjeve	më së voni deri më 20 tetor
7.2	Dorëzimi i materialit zgjedhor trupave punuese para votimit	më së voni deri më 22 tetor, në orën 24:00
7.3	Dorëzimi i materialit zgjedhor komisioneve zgjedhore	më së voni deri më 23 tetor, në orën 24:00
7.4	„Heshtja parazgjedhore” – ndalimi i propagandës zgjedhore	nga 23 tetori në orën 24, deri në mbylljen e vendotimeve më 26 tetor, në orën 20:00
7.5	Hapja e vendotimeve dhe e votimit	më 26 tetor, prej orës 7:00 deri në 20:00
8. Verifikimi dhe publikimi i rezultateve të zgjedhjeve		
8.1	Dorëzimi i materialeve zgjedhore te Komisioni Zgjedhor Republikan nga vendvotimi pas votimit	më së voni deri më 27 tetor, në orën 8:00
8.2	Verifikimi dhe publikimi i raporteve me rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve	më së voni deri më 30 tetor, në orën 20:00
8.3	Shikimi i materialeve zgjedhore në ambientet e Komisionit Zgjedhor Republikan	më së voni deri më 31 tetor, në orën 24:00
9. Mbrojtja e të drejtës zgjedhore		
9.1	Paraqitja e kundërshtimeve te Komisioni Zgjedhor Republikan	Në afat prej 24 orësh, nga momenti kur është miratuar vendimi, veprimi i kryer apo lëshimi i bërë
9.2	Marrja e vendimit dhe dorëzimi i tij sipas ankesës	në afat prej 48 orësh, nga momenti i pranimi të ankesës
9.3	Ankesë në Gjykatën Administrative kundër vendimit të Komisionit Republikan Zgjedhor	në afat prej 48 orësh, nga pranimi i ankesës
9.4	Dorëzimi i kundërshtimeve në dokumentet e Gjykatës Administrative	në afat prej 24 orësh, nga pranimi i ankesës
9.5	Sjellja e vendimit sipas ankesës	në afat prej 48 orësh, nga pranimi i ankesës
10. Ndarja e mandateve dhe dhënia e certifikatave mbi zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Kombëtar		
10.1	Miratimin e vendimit për ndarjen e mandateve të anëtarëve të Këshillit Kombëtar	inë afat prej tri ditësh, nga dita e verifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve
10.2	Dorëzimi i vendimeve mbi ndarjen e mandateve të anëtarëve të këshillit kombëtar Ministrisë së Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale dhe publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”	menjëherë pas miratimit të vendimit
10.3	Lëshimi i certifikatave mbi zgjedhjen për anëtar të Këshillit Kombëtar	menjëherë pas caktimit të mandateve, përveç nëse nuk ekziston kontest administrativ

Pikat e rëndësishme për zgjedhjet për Këshillat kombëtare të pakicave kombëtare

Zgjedhjet e ardhshme janë për anëtarë të 20 këshillave kombëtare. Nga këto, 17 këshilla kombëtare të pakicave kombëtare do të zgjedhen drejtpërdrejtë me deklarin e anëtarëve të pakicave kombëtare me votim të drejtpërdrejtë të fshehtë, ndërsa për 3 këshilla kombëtar votimi do të bëhet nëpërmjet kuvendit elektorale.

Çka janë këshillat kombëtare të pakicave kombëtare?

Këshillat kombëtare të pakicave kombëtare janë kategori kushtetuese, siç përkruhet në nenin 75 të Kushtetutës së Serbisë në vitin 2006, në të cilën qytetarët janë deklaruar drejtpërdrejtë përmes referendumit. Si e tillë, ajo është e garantuar me aktin më të lartë juridik, dhe është e rregulluar me Ligj të veçantë për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare. Përkufizimi ligjor i këshillit kombëtar, sipas nenit 2 të Ligjit për këshillat kombëtare të vitit 2009, është si më poshtë:

„ Për realizimin e të drejtave për vetëqeverisje në kulturë, arsim, informim dhe në përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit, pjesëtarët e pakicave kombëtare në Republikën e Serbisë mund t'i zgjedhin këshillat e veta kombëtare.

Këshilli kombëtar e përfaqëson pakicën kombëtare në fushën e arsimit, kulturës, informimit në gjuhën e pakicës kombëtare dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit, merr pjesë në procesin e vendimmarrjes ose vendos për çështjet nga këto fusha dhe i themelon institucionet, shoqëritë ekonomike dhe organizatat e tjera nga këto fusha.”

E drejta zgjedhore

E drejta zgjedhore e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për zgjedhjen e këshillave kombëtare e nënkupton të drejtën që pjesëtarit i pakicës kombëtare të mund:

- të zgjedhë anëtarët e këshillit kombëtar,
- të zgjedhet si anëtar i këshillit kombëtar,
- të propozojë kandidatë për anëtarë të këshillit kombëtar,

Numri i pjesëtarëve të pakicave kombëtare në Serbi sipas regjistrimit të popullsisë nga viti 2011.

Hungarez	253899	Bunjevc	16706
Rom	147604	Rusin	14246
Boshnjak	145278	Goran	7767
Kroat	57900	Shqiptarë	5809
Siloven	52750	Ukranias	4903
Malazez	38527	Gjerman	4064
Vlleh	35330	Siloven	4033
Rumun	29332	Rus	3247
Jugosllaven	23303	Të tjerë	17558
Maqedonas	22755	Nuk janë deklaruar	160346
Mysliman	22301	Përkatësia rajonale	30771
Bullgar	18543		

- të jetë i informuar për zgjedhjet për këshilla kombëtare, për kandidatët për anëtarë të këshillit kombëtar, si edhe për programet e tyre,

- të regjistrohet në listë të veçantë të zgjedhjeve të pakicës kombëtare,

- të votojë për zgjedhjen e këshillit kombëtar dhe

- të ketë të drejtën për mbrojtjen e të drejtave lidhur me zgjedhjen e këshillit kombëtar

Madhësia e Këshillit kombëtar

Madhësinë e këshillit kombëtar e përcakton Ligji mbi këshillat kombëtare të pakicave kombëtare duke marrë parasysh numrin e pakicës kombëtare.

Ligji përcakton që Këshilli Kombëtar të ketë të paktën 15, dhe më së shumti 35 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i vogël se 10.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 15 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 10.000 por më i vogël se 20.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 19 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është midis 20.000 dhe 50.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 23 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është midis 50.000 dhe 100.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 29 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 100.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 35 anëtarë.

Bojkoti i regjistrimit të popullsisë

Përderisa disa pakica kombëtare kanë zhvilluar fushatë intensive në mesin e pjesëtarëve të vet me qëllim që numër sa më i madh i tyre të deklarohet gjatë regjistrimit që i përketnjë komuniteti kombëtar të caktuar, disa pakica kombëtare kanë bojkotuar regjistrimin e popullsisë me ftesë dhe iniciativë të udhëheqësve të tyre politikë.

Një qëndrim i tillë ndaj regjistrimit të popullsisë ka shkaktuar një numër problemesh atyre pjesëtarëve të pakicës kombëtare, në rastin tonë, pakicës kombëtare shqiptare, e cila, përveç të qenit më pak e përfaqësuar, merr edhe shumë

Këshillat kombëtare të pakicave kombëtare janë kategori kushtetuese, siç përkruhet në nenin 75 të Kushtetutës së Serbisë në vitin 2006.

Në këtë vit 2014. janë krijuar kushtet për zgjedhje edhe për 2 këshilla tjerë kombëtar, edhe atë: Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare polake dhe Këshillit Kombëtar i pakicës kombëtare malazeze

më pak fonde nëpërmjet Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare.

Numri i tyre, sipas regjistrimit të vitit 2011, zyrtarisht është 5.809, ndërsa sipas regjistrimit të vitit 2002 ka qenë 61.647. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë së Serbisë nga viti 2011. japin një përgjigje të qartë se cilat pakica kombëtare ekzistojnë dhe se cili është numri i tyre, që më vonë është marrë si referencë për të përcaktuar mënyrën e zgjedhjes për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare, si dhe për të përcaktuar numrin e anëtarëve të këshillit.

Këshillat kombëtare 2014

Deri në vitin 2014, 20 këshilla kombëtare të pakicave kombëtare kanë funksionuar, midis të cilëve ka qenë edhe Federata e Komunave Çifute të Serbisë, e cila ka kryer funksionin e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare çifute.

Në këtë vit 2014. janë krijuar kushtet për zgjedhje edhe për 2 këshilla tjerë kombëtar, edhe atë: Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare polake dhe Këshillit Kombëtar i pakicës kombëtare malazeze.

Megjithatë, që këto dy këshilla të themelohen, është e nevojshme që zgjedhjet të kryhen me sukses.

Themelimi i këshillave nacionale të pakicave kombëtare

Që një pakicë e caktuar kombëtare të iniciojë procesin e formimit të Këshillit kombëtar dhe zgjedhjen e anëtarëve të këshillit, gjëja e parë që ajo duhet të bëjë është që të dorëzojë kërkesën për formimin e listës së veçantë zgjedhor, të cilën duhet ta mbështesin të paktën 5% të pjesëtarëve të asaj pakice, kurse numri i të cilëve nuk mund të jetë më pak se 300. Mbështetja për formimin e listës së veçantë zgjedhore jepet personalisht duke plotësuar formularin dhe me verifikimin e nënshkrimit.

Zgjedhjet e drejtpërdrejta edhe elektorale

Pas shqyrtimit të listave zgjedhore të përkohshme, është vërtetuar se 4 këshilla nuk i plotësojnë kushtet për zbatimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare. Këto këshilla do të zgjidhen përmes kuvendit elektor, ndërsa 17 këshillat e tjerë do të zgjidhen drejtpërdrejt.

Për të përcaktuar nëse kushtet për zgjedhje të drejtpërdrejta janë plotësuar, Ministria përkohësisht "i mbyll" listat e veçanta zgjedhore, edhe atë 24 orë para shpalljes së zgjedhjeve me qëllim që në momentin e shpalljes së zgjedhjeve të jetë e qartë nëse pakica e caktuar kom-

Zgjedhjet në dhjetë gjuhë

Afati i fundit për paraqitjen e listave të zgjedhjeve për Këshillat kombëtare të pakicave kombëtare është 10 tetor. Materiali zgjedhor do të shtypet në dhjetë gjuhë, dhe do të votohet në të paktën 860 vende.

Zgjedhjet janë shpallur për këshillat kombëtare të pakicës kombëtare shqiptare, ashkalive, boshnjake, bullgare, bunjevceve, greke, egjiptiane, hungareze, maqedonase, gjermane, poloneze, rome, rumune, rusin, sllovaqe, sllovene, ukrainase, kroate, malazeze dhe çeke.

Pakica turke dhe ruse kanë vendosur të mos shkojnë në zgjedhje, kurse Goranët janë deklaruar se nuk ndjehen si pakicë.

bëtare zgjedh drejtpërdrejt këshillin e vet apo përmes kuvendit elektor.

Barazia gjinore

Ligji ka mbrojtur gjininë më pak të përfaqësuar ashtu që ka kushtëzuar që në listat e kandidatëve, ashtu siç është për zgjedhjet për deputet, midis çdo tre kandidatëve një kandidat të jetë pjesëtarë i gjinisë më pak të përfaqësuar.

Në këtë mënyrë, në radhë të parë janë mbrojtur gratë dhe janë përfshirë në mënyrë aktive në procesin zgjedhor.

Qendrat e votimit dhe njoftimi

Sikur edhe me zgjedhjet e tjera, qendrat e votimit në zgjedhjet e drejtpërdrejta për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare hapen në ora 7 të mëngjesit dhe mbyllen në ora 20:00. Gjatë kësaj periudhe qendrat e votimit janë të hapura vazhdimisht.

Ligji parasheh që secilit votues të

regjistruar në listën e veçantë të zgjedhjeve, jo më vonë se 5 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, t'i dërgohet njoftimi për ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, me numrin dhe adresën e qendrës së votimit në të cilën votohet dhe me numrin nën të cilin është regjistruar në kopje të listës së veçantë të zgjedhjeve.

Qendra e votimit

Qendra e votimit përcaktohet për votim të jo më pak se 100, dhe jo më shumë se 2.500 votuesve të regjistruar në lista të veçanta të zgjedhjeve.

Jashtëzakonisht, qendra e votimit mund të caktohet edhe për votimin e më pak se 100 votuesve nëse, për shkak të largësisë ose pozitës së pavolitshme gjeografike, zgjedhësit do ta kishin dukshëm më vështirë të votonin në ndonjë qendër tjetër të votimit.



Sikur edhe me zgjedhjet e tjera, qendrat e votimit në zgjedhjet e drejtpërdrejta për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare hapen në ora 7 të mëngjesit dhe mbyllen në ora 20:00



Kompetencat e Këshillave kombëtare të pakicave kombëtare

Kompetencat e këshillave kombëtare të pakicave kombëtare janë nga ato më interesante, por në të njëjtën kohë edhe pjesa më e diskutueshme e Ligjit për Këshillat kombëtare të pakicave kombëtare. Përderisa disa besojnë se mu në këtë pjesë të ligjit reflektohet interesi themelor për të siguruar autonominë e vërtetë të pakicave kombëtare, të tjerët sfidojnë kushtetutshmërinë e dhënies së kompetencave në një masë të tillë. Në fillim të këtij viti, edhe Gjykata Kushtetuese bëri një deklaratë lidhur me kompetencat e këshillave kombëtare duke vlerësuar që dispozitatë caktuara nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Serbisë.

Përveç kompetencave të përgjithshme të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare, Ligji rregullon edhe kompetencat e caktuara në katër fusha, edhe atë: në fushën e kulturës, në fushën e arsimit, në fushën e informimit dhe në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të shkrimit.

Ligjvënësi ka vlerësuar se këto janë fusha në të cilat kompetencat e këshillave kombëtare mundën në mënyrë më efektive dhe me më shumë sukses të mbrojnë parimin e autonomisë kulturore dhe identitetit kulturor, si dhe fakti që në këto fusha gjenden specifikat e pakicave kombëtare. Gjithçka tjetër në masë të mjaftueshme është e mbrojtur dhe e rregulluar me Kushtetutë dhe Ligjet të cilat kanë të bëjnë me të gjithë qytetarët e republikës.

Ligji mbi këshillat kombëtare kompetencave të këshillave kombëtare ia dedikon seksionin 3 të Ligjit, duke numëruar në nenin 10 kompetencat e përgjithshme, të cilat janë gjithsej 15.

Ligji thotë që Këshilli kombëtar në pajtim me ligjin dhe statutin e vet, përmes organeve të veta në mënyrë të pavarur:

- 1) e miraton dhe e ndryshon statutin e këshillit kombëtar;
- 2) e miraton planin financiar, raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare;
- 3) disponon me pronë të vetë;
- 4) vendos për emërtimin, simbolet dhe vulën e këshillit kombëtar;
- 5) i përcakton propozimet e simboleve kombëtare, shenjave dhe të festave të pakicës kombëtare;
- 6) themelon institucione, shoqata, fonda-

cione, shoqëri ekonomike në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;

- 7) i propozon përfaqësuesit e pakicës kombëtare në këshill për marrëdhënie ndërnacionale në njësi të vetëqeverisjes vendore;

8) përcakton dhe ndan mirënjohje;

9) inicion miratimin dhe e përcjell zbatimin e ligjit dhe të dispozitave të tjera nga fusha e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;

10) merr pjesë në përgatitjen e dispozitave dhe propozon ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave me të cilat rregullohen të drejtat e garantuara me Kushtetutë të pakicave kombëtare në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;

11) propozon dispozita të veçanta dhe masa të përkohshme në fushat në të cilat realizohet e drejta për vetëqeverisje, për arritjen e barazisë së plotë midis pjesëtarëve të pakicave kombëtare dhe qytetarëve të cilët i takojnë shumicës;

12) e fillon procedurën para Avokatit të popullit, avokatit të popullit krahinor dhe lokal dhe para organeve të tjera kompetente, kur vlerëson se është bërë shkelja e të drejtave dhe e lirive të pjesëtarëve të pakicave kombëtare të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj.

13) e fillon procedurën nga pika 12) e këtij neni në emër të pjesëtarëve të pakicës kombëtare, duke e siguruar më parë autorizimin me shkrim;

14) merr qëndrime, fillon nisma dhe ndërmerr masa lidhur me të gjitha çështjet të cilat drejtpërsëdrejti janë të lidhura

me pozitën, identitetin dhe të drejtat e pakicës kombëtare;

15) vendos për çështjet e tjera të cilat i janë besuar me ligj.

Kompetencat në fushën e arsimit

Këshillit kombëtar të pakicave kombëtare me Ligj iu janë ndarë të drejtat e themelimit respektivisht të drejta që në mënyrë të pavarur apo bashkë me Republikën, krahinën autonome, vetëqeverisjen lokale ose me personin tjetër juridik të themelohet institucione të edukimit, arsimit, për mirëqenien sociale të nxënësve dhe të studentëve.

Edhe pse e drejta e themelimit në fushën e arsimit, është një nga të drejtat themelore që rrjedh nga liria e vetorganizimit në fushën kryesore të ruajtjes së identitetit kulturor, ekzistojnë pengesa të numërta në realizimin e asaj të drejte, kurse pengesa e parë dhe themelore është mungesa e mjeteve për themelimin e institucioneve të qëndrueshme. Kjo e drejtë gjithsesi rol më të rëndësishëm do të luajë në të ardhmen kur të krijohen kushtet që këshillat kombëtare të shfrytëzojnë këtë mundësi ligjore.

Deri atëherë, këshillat kombëtare kanë mundësi që të ndikojnë në planet mësimore dhe programet e arsimit fillor dhe të mesëm dhe edukimin në baza të programit edukativ të cilat shprehin veçantësinë e pakicës kombëtarë, posaçërisht nga fusha e historisë, edukimit muzikor dhe figurativ.

Me dhënien e mendimit, këshillat kombëtare mundën formalisht të ndikojnë edhe në zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, bordeve drejtuese të shkollave ose ndonjë institucion tjetër arsimor ose edukativ. Është parashikuar që në institucionet ku mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicave kombëtare, pjesërisht ose në tërësi, Këshilli kombëtar ka të drejtë të propozojë një anëtar të bordit të drejtorëve në institucionet e themeluara nga Republika, krahina autonome ose njësi e vetëqeverisje lokale.

Tekstet për zbatimin e mësimin në gjuhën e pakicave miraton Ministri i arsimit, por me propozimin e Këshillave kombëtare.

Gjithçka tjetër në masë të mjaftueshme është e mbrojtur dhe e rregulluar me Kushtetutë dhe Ligjet të cilat kanë të bëjnë me të gjithë qytetarët e republikës

Celelalte competente pe care consiliul național le-a avut, ca de exemplu, stabilirea criteriilor pentru alegerea redactorului-șef, Curtea Constituțională le-a apreciat ca fiind neconstituționale

Përveç një numri të opinioneve për të cilat këshillat kombëtare kanë të drejtë në bazë të Ligjit, ata në mënyrë të pavarur mund të krijojnë bursa nga burimet e veta, përcaktojnë përfaqësuesin e tyre në Këshillin kombëtar për arsim dhe Këshillin kombëtarë për arsim të lartë.

Kompetencat në fushën e kulturës

Si edhe në fushën e arsimit, këshillat kombëtare të pakicave kombëtare, mund sipas ligjit në mënyrë të pavarur ose së bashku me Republikën, krahinën autonome, vetëqeverisjen lokale apo subjekt tjetër juridik të themelojnë institucione kulturore për të ruajtur, promovuar dhe zhvilluar veçoritë kulturore dhe për të ruajtur identitetin kombëtar të pakicave kombëtare.

Këshilli Kombëtar mund të vendosë për ndonjë institucion të caktuar kulturor, themelues i të cilit është Republika, që është me rëndësi të veçantë për ruajtjen e identitetit të pakicave kombëtare, dhe në atë rast, Këshilli Kombëtar emëron një anëtar të bordit drejtues të institucionit dhe të jep mendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit drejtues dhe drejtorit.

Ndër të tjera, Këshilli kombëtar përcakton se cilët institucione dhe ngjarje në fushën e kulturës janë me rëndësi të veçantë për ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e veçorive dhe identitetit kombëtar të ndonjë pakice kombëtare të caktuar, përcakton strategjinë e zhvillimit të kulturës së pakicave kombëtare dhe përcakton se cilat janë pasuritë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme me rëndësi të veçantë për pakicën kombëtare.

Kompetencat e tjera në fushën e kulturës kanë të bëjnë me shprehjen e mendimeve dhe përcaktimin e përfaqësuesit të vet në Këshillin kombëtar për kulturë, i cili pa të drejtë vendosjeje, merre pjesë në punën e tij kur diskutohen çështje të rëndësishme për kulturën e pakicave kombëtare.

Kompetencat në fushën e informimit

Sa i përket fushës së informimit, ligjvënësi në mënyrë të qartë ka autorizuar Këshillin Kombëtar, që në mënyrë të përcaktuar me ligj, pavarësisht ose së bashku me person tjetër juridik mund të themelojë institucione dhe shoqëri ekonomike për të kryer punë nga fusha

gazetare-botuese dhe radio-televizive, shtypjes dhe riprodhimit të mediave të gjiruara dhe të kryej të drejtat dhe detyrimet e themeluesit.

Nga ana tjetër, Këshilli kombëtar, në mediat ku themelues është Republika, ka të drejtë për opinion kur bëhet fjalë për emërimin e kryeredaktorit për programet në gjuhët e pakicave. Kompetencat e tjera të cilat këshilli i ka pasur, për shembull, vendosja e kriterëve për përzgjedhjen e kryeredaktorit, Gjykata Kushtetuese i ka cilësuar si antikushtetuese.

Si kompetenca të tjera të Këshillit në fushën e informimit, përmenden: miratimi i strategjisë së zhvillimit të informimit në gjuhën amtare, dhënia e sugjerimeve të ndryshme dhe rekomandimeve organeve republikane dhe përcakton përfaqësuesin në Këshillin Republikan të agjencisë transmetuese cili merr pjesë në punën e Këshillit, por pa të drejtë vendosjeje, dhe vetëm kur merren parasysht çështjet në lidhje me informimin në gjuhën e pakicës.

Kompetencat në fushën e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit zyrtar

Përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicës kombëtare përfshin:

- Përdorimin e emrit personal (emrit dhe mbiemrit) dhe regjistrimi i tij në dokumente publike dhe dokumente zyrtare në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare,
- Dhënen e dokumenteve publike dhe udhëheqja e evidencave zyrtare dhe përmbledhjeve të të dhënave publike në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare dhe pranimi i atyre dokumenteve në atë gjuhë si të vlefshme,
- Udhëheqjen e procedurave administrative dhe ligjore në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare
- Përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtarë kur procedura udhëhiqet në gjuhën serbe,
- Përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare në komunikim të organeve me autorizim publik me qytetarët,
- Përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare në listat votuese dhe

materialin zgjedhor

- Përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare në punën e trupave përfaqësuese,
- Publikimin e ligjeve dhe rregullave tjera edhe në gjuhët e pakicave kombëtare
- Shkrimi i emrave të vendeve dhe emrave tjerë gjeografik, emrave të rrugëve dhe shesheve, emrave të organeve dhe organizatave, shenjave të trafikut, lajmërimit dhe vërejtjet për publikun dhe shkrimeve tjera publike edhe në gjuhët e pakicave kombëtare,
- Shkrimin e emrit të ndërmarrjes, institucionit dhe personit tjetër juridik edhe në gjuhën e pakicës kombëtare.


Karta mbi gjuhët regjionale dhe të pakicave të Këshillit të Evropës paraqet kontratën më të rëndësishme ndërkombëtare nga kjo fushë.

Me ratifikimin e Kartës për gjuhët regjionale ose të pakicave në Serbi në pikëpamje të përdorimit të gjuhës para organeve të jurisprudencës është obliguar që në procedurën penale të fajësuarit i garanton të drejtë të përdor gjuhën e vet regjionale ose të pakicave dhe të sigurojë që kërkesa dhe dëshmia, pavarësisht faktit nëse është në formë të shkruar ose me shkrim, nuk konsiderohet i papranueshëm vetëm për arsye se është i formuluar në gjuhën regjionale ose të pakicave.

Në pikëpamje të përdorimit të gjuhës së pakicave në procedurat gjyqësore civile, Serbia është obliguar që të lejojë që pala, kurdo që duhet të paraqitet vetë përpara gjyqit, mund të përdor gjuhën e vet regjionale ose të pakicave pa shpenzime shtesë. Përveç kësaj, Serbia është obliguar që realizimin e këtyre të drejtave në përdorimin e gjuhës dhe përdorimit të domosdoshëm të përkthyesit të mos shkaktojë shpenzime shtesë te personat e interesuar.

Serbia është obliguar edhe të mos mohojë vlefshmërinë e dokumenteve juridike të bëra në gjuhën regjionale ose të pakicave, si dhe që tekstet më të rëndësishme të legjisllacionit nacional t'i bëjë në dispozicion edhe në gjuhët regjionale dhe të pakicave.

Karta mbi gjuhët regjionale dhe të pakicave të Këshillit të Evropës paraqet kontratën më të rëndësishme ndërkombëtare nga kjo fushë



Centar za istraživanja migracija
Center for Migration Studies

Ky publikim financiarisht është mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Beograd, misioni i OSBE në Serbi dhe Fondacioni për shoqëri të hapur. Opinionet e publikuara në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të Qeverisë dhe organizatave të cilat financojnë këtë projekt